



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 1

Tiranë – E hënë, 18 janar 2016

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|---|--|
| Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 14623, datë 7.12.2015 | Me objekt hapjen e procedurave të falimentimit për subjektin, shoqëria tregtare “Italkrom Albania” sh.p.k..... 3 |
| Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 10500, datë 15.12.2015 | Me objekt hapjen e procedurave të falimentimit për subjektin, shoqëria tregtare “AL.P.IN” sh.a..... 5 |
| Kërkesë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 171, datë 13.1.2016 | Për shprehje interesi..... 10 |



VENDIM
Nr. 14623, datë 7.12.2015

**PËR ZHVILLIMIN E FAZËS SË DYTË
TË HAPJES SË PROCEDURAVE TË
FALIMENTIMIT**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Marinela Osmani, gjyqtare,

Pasi u njoh me aktet e çështjes tregtare nr. 14623, datë 7.12.2015, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë.

PERSONA TË TRETË: Shoqëria “Italkrom Albania” sh.p.k., me seli në Tiranë, adresa: rruga “Andon Zako Çajupi”, nr. 11.

OBJEKTI: Hapja e procedurave të falimentimit për subjektin, shoqëria tregtare “Italkrom Albania” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar,

VËREN:

1. Me kërkesën drejtuar Gjykatës, pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, ka kërkuar hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k.

2. Me vendimin nr. 11369, datë 13.11.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në prova dhe në ligj.

- ...

3. Mbi ankimin e palës kërkuese Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin 75, datë 10.2.2015, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. 11369, datë 13.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesës për çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Italkrom Albania” sh.p.k.

Në lidhje me parashikimet ligjore në përputhje me rastin konkret, Gjykata vëren se:

4. Neni 18/4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “*Seksioni tregtar i Gjykatës së rrethit, brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni, vendos: c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit*”.

5. Neni 26 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. *Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit; ç) të dbënat e parashikuara në nenin 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës... 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit*”.

Në përfundim, pas analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se:

6. Sa më lart dhe në kushtet kur është vendosur pranimi i kërkesës dhe hapja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., të gjithë kreditorët e shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi gjyqësor. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

7. Për efekt të publikimit të këtij vendimi, në respektim të kërkesave të ligjit “Për falimentimin”, të ndryshuar, urdhërohet:

- Publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit, shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,



me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar).

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikën e Shqipërisë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

- Publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shqip”.

8. Bazuar në nenin 8/2 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), për kryerjen e njoftimeve dhe shpalljeve publike sipas nenit 9 të ligjit, dhe caktimin e mbledhjeve brenda afateve të parashikuara në këtë vendim, ngarkohet administratorja e falimentimit, Mimoza Cara. Shpenzimet në lidhje me këto veprime procedurale i ngarkohen masës së falimentimit. Si rrjedhim, një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet dhe administratores së falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., Mimoza Cara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “ItalKrom Albania” sh.p.k., znj. Mimoza Cara, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 13, datë 16.10.2012, me adresë: bulevardi “Zogu I”, Qendra e Biznesit Veve.

Faqe | 4

2. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

3. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

4. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Mimoza Cara.

5. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

6. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

7. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

8. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., Mimoza Cara.

9. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ItalKrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikën e Shqipërisë.



12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

14. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

15. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shqip”.

U shpall në Tiranë, sot në datën 17.12.2015

GJYQTARE
Marinela Osmani

VENDIM

Nr. 10500, datë 15.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Marinela Osmani, Gjyqtare,

Asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Maja, sot në datën 15.12.2015, përfundoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile nr. 10500, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., me seli në Tiranë, adresa: Rruga e Kavajës, pallati 71, shk. 1, ap. 4, përfaqësuar nga juristi Edison Harizaj, zgjedhur me autorizimin, datë 2.9.2015.

PERSONA TË TRETË: Shoqëria “AL.P.IN” sh.a., me seli në Tiranë, adresa: Rruga e Durrësit, Shkolla e Partisë, përfaqësuar në gjykim nga av. Aranit Roshi, me licencë nr. 3791, zgjedhur me autorizimin datë 16.11.2015 dhe Përparim Brahimaj, me autorizimin datë 5.10.2015.

OBJEKTI: Hapja e procedurave të falimentimit për subjektin, shoqëria tregtare “AL.P.IN” sh.a.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, si më lart, pasi:

Dëgjoj:

- Palën kërkuese, shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., përfaqësuar nga juristi Edison Harizaj, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit;

- Personin e tretë shoqëria “AL.P.IN” sh.a., përfaqësuar në gjykim nga av. Aranit Roshi, i cili përfundimisht rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurave të falimentimit për shoqërinë “AL.P.IN” sh.a.

Ia nënshtroi hetimit gjyqësor dhe çmoi provat e paraqitura.

Shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Me kërkesën drejtuar kësaj Gjykate, pala kërkuese, kërkon hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se:

2. Shoqëria “AL.P.IN” sh.a. është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, në datën 23.3.2002. Kjo shoqëri ushtron aktivitetin tregtar në fushën e importit, eksportit, transport, tregtisë me shumicë e pakicë të të gjithë gamës së produkteve petroliere; organizim në territorin e Republikës së Shqipërisë të një sistemi shpërndarje dhe shitjeje të GPL-së (gaz vajguror të lëngshëm për përdorim shtëpiak e industrial me bombola, serbatorë të vegjël, serbatorë e kanalizime); projektim dhe ndërtim në territorin e Republikës së Shqipërisë të një rrjeti shpërndarjeje karburanti (benzinë, naftë, gazoil GPL); import eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të karburanteve për mjete e fluturimit ajror; ndërtim magazinash (sigurim magazinimi) dhe impiantesh për mbushjen e shisheve GPL; realizim të veprimtarisë në bazë të kontratës për import, duke u përgjigjur për markën e prodhimit; themelim ose pjesëmarrje në shoqëri që veprojnë si stacione të shitjes së karburanteve me cilësinë e personit juridik me kusht që të furnizohen vetëm nga shoqëria; çdo operacion financiar tregtar, industrial me pasuri të paluajtshme ose të luajtshme që mund të lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një nga objektet të shoqërisë; hartim kontratash me persona juridikë e fizikë, shqiptarë ose të huaj, me qëllim që të realizojë zgjerimin e veprimtarisë së shoqërisë.



3. Gjatë gjykimit u provua që mes palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar një marrëdhënie juridike detyrimi, e cila buron prej “Kontratës së kredisë me kufi” nr. 8498 rep., nr. 3211kol., datë 3.12.2008 (të ndryshuar). Në këtë kontratë është parashikuar dhënia e një kredie në llogarinë rrjedhëse të kredimarrësit, deri në shumën prej 150.000.000 ALL. Në kushtet e mospërbushjes së detyrimit prej kredimarrësit, kreditori shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Me vendimin nr. 10259, datë 24.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur lëshimi i urdhrin të ekzekutimit për kontratën e kredisë, si më lart, konkretisht “Kontratës së kredisë me kufi” nr. 8498 rep., 3211 kol., datë 3.12.2008 (të ndryshuar).

4. Po, midis palës kërkuese shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., në cilësinë e kredidhënësit, është nënshkruar me shoqërinë “AL.P.IN” sh.a., në cilësinë e kredimarrësit, dhe kontrata e kredisë me Kufi nr. 1618 rep., nr. 634 kol., datë 22.4.2010, nëpërmjet së cilës Banka i ka akorduar kredimarrësit, përkundëjt kushteve të përcaktuara në kontratë, një shumë kredie prej 20,000,000 lekësh (njëzet milionë), me afat kthimi deri më 30 nëntor 2010. Afati i kthimit të kredisë është shtyrë deri më 29 gusht 2012, me marrëveshje të palëve, duke u ristrukturuar kredia nga lekë në euro. Me vendimin nr. 10260, datë 26.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi kërkesën e kreditorit, i cili ka pretenduar se nga ana e kredimarrësit nuk është përbushur detyrimi sipas kushteve të kontratës, është vendosur lëshimi i urdhrin të ekzekutimit për kontratat e kredisë.

5. Mbi bazën e titujve ekzekutivë, urdhrave të ekzekutimit dhe kërkesës së kreditorit, në datën 4.12.2012, është bërë regjistrimi i procedurës përmbartimore pranë shoqërisë përmbartimore “E.P.S.A” sh.p.k., procedurë që aktualisht është në vijim e sipër.

6. Duke pretenduar se personi i tretë shoqëria “AL.P.IN” sh.a., është në kushtet e paaftësisë paguese, pala kërkuese shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., me cilësinë e kreditorit i është drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit.

Në lidhje me parashikimet ligjore në përputhje me rastin konkret, Gjykata vëren se:

7. Neni 13 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. *Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak. 2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryhen pagesat... 4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë...”*

8. Neni 14/1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. *Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose kreditorëve. Në rastin e personave juridikë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë trevjeçare...”*

9. Në nenin 17 të ligjit parashikohet dhe legjitimimi aktiv i kreditorit për të kërkuar hapjen e procedurës së falimentimit. Kështu, në këtë dispozitë parashikohet: “1. *Kërkesa e kreditorit pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, kur ai ka një interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit, kur paraqet kërkesën sipas ligjit dhe nëse Gjykata çmon se shkaqet për hapjen e procedurës së falimentimit janë të mjaftueshme dhe bindëse për të. Vlerësohen se kanë interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit, kreditori, i cili ka ndaj pasurisë së debitorit një interes me karakter pasuror dhe autoritetet fiskale. Shkakut për hapjen e procedurës së falimentimit prezumohet se ekziston nëse debitori, pavarësisht se nuk e ka kundërshtuar pretendimin, nuk e ka shlyer këtë detyrim tre muaj pas datës së maturimit të pagesës. 2. Nëse kërkesa e kreditorit pranohet, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit thërret dhe dëgjon pretendimet e debitorit.”*

10. Neni 18/4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos : **c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit**”.

11. Neni 26 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. *Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e*



procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit; ç) të dhënat e parashikuara në nenin 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës... 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit”.

12. Në përfundim pas analizës së faktit, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse dhe analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, ajo duhet të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

13. Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

14. Fillimi, në rrugë gjyqësore, i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit:

a) gjendje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim; ose/dhe

b) mbingarkesës së subjektit me borxhe.

15. Legjitimitimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit, e gëzon kreditori, debitori, si dhe organet tatimore, në rast konstatimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale trevjeçare. Në rastet kur kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit paraqitet nga vetë subjekti debitor, ky i fundit duhet t'i evidentojë gjykatës listën e pasurive dhe të ardhurave, listën e kreditorëve me vlerat respektive të detyrimit. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, Gjykata arrin në përfundimin se

pala kërkuese legjitimohet të paraqesë këtë kërkesë, pasi ka cilësinë e kreditorit në procedurën e falimentimit dhe ndaj pasurisë së debitorit vlerësohet se ka një interes me karakter pasuror.

16. Në zbatim të parashikimeve të nenit 18 të ligjit, me qëllim për të hetuar rreth pretendimeve të kërkuarit për ekzistencën e gjendjes së falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., Gjykata emëroi si administratore të përkohshme të falimentimit znj. Mimoza Çibuku, së cilës iu caktuar si detyrë të verifikojë ekzistencën e shkakut/shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, në drejtim të gjendjes së paaftësisë paguese të subjektit apo/dhe mbingarkesës së tij me borxhe, të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit, të verifikojë nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë, si dhe mundësinë për vijimësinë e veprimtarisë tregtare të debitorit.

17. Nga raporti i paraqitur nga administratorja e përkohshme e falimentimit, rezultuan këto përfundime:

- Ekzistenca e shkakut të hapjes së procedurës së falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a. është real. Nga provat, sipas aktit, rezulton se shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, në kushtet kur ka detyrime të pashlyera në datën e maturimit të tyre (mbi tre muaj) dhe nuk ka gjendje mjetesh monetare për likuidim;

- Pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit;

- Debitori nuk ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë tregtare.

18. Pasuria e shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., sipas aktit të ekspertimit dhe provave shkresore, mbi bazën e deklarimeve të debitorit për shkak të problemeve në pasqyrën financiare të vitit 2014, deri në datën 31.12.2014, është në aktive në vlerën 290,306,975 lekë dhe detyrime në vlerën 207,829,062 lekë. Përfundimisht, rezulton se shoqëria “AL.P.IN” sh.a., nuk rezulton, sipas ekspertës, në kushtet e mbingarkesës në borxhe.

19. Në lidhje me prapësimet e paraqitura nga personi i tretë, Gjykata vëren se akti i ekspertimit, i realizuar nga administratorja e përkohshme e falimentimit, është mbështetur në bazë të dokumentacionit të paraqitur me cilësinë e provës nga vetë kjo palë. Nga kjo palë nuk u paraqit asnjë prapësim konkret dhe të bazuar në ndonjë provë,



i cili provon ndonjë fakt të ndryshëm, të panjohur dhe që vë në diskutim përfundimet e aktit të ekspertimit.

20. Pasuritë e shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit. Duke përlogaritur shpenzimet e procedurës së falimentimit, ku përfshihet dhe pagesa e administratores së falimentimit, administratorja e përkohshme e falimentimit arrin në përfundimin se pasuria e shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., mbulon shpenzimet e procedurës së falimentimit.

21. Në lidhje me nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë, administratorja e përkohshme e falimentimit ka çmuar marrjen e masës së sigurimit duke pezulluar masat e sigurisë dhe të ekzekutimit në lidhje me ekzekutimin e kredisë. Në lidhje me këtë konstatim, Gjykata vëren se nga ana e ekspertit vihet në dukje nevoja për marrjes së masës për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Nga interpretimi i dispozitave të ligjit del e qartë se me shpalljen e hapjes së procedurës së falimentimit, pasuria e debitorit që sekuestrohet nga përmbaruesi gjyqësor dhe shumat e fituara nga shitja e pasurive, bëhen pjesë e masës së falimentimit dhe përmbaruesi gjyqësor duhet t’ia dorëzojë ato administratorit të falimentimit (neni 74 e vijues i ligjit.) Në këtë kuadër, Gjykata vendos një masë për sigurimin e masës së falimentimit dhe jo pezullimin e një procedure përmbarimore, e cila nuk ekziston më, me çeljen e procedurës së falimentit.

22. Në lidhje me verifikimin e mundësisë për vazhdimësinë e veprimtarisë nga debitori, në bazë të aktit të ekspertimit, u provuar se shoqëria “AL.P.IN” sh.a., është bllokuar në vijimin e aktivitetit të saj tregtar dhe nuk ka likuiditete për rifillimin e veprimtarisë së saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj.

23. Sa më lart dhe në përfundim të hetimit gjyqësor, në kushtet kur vërtetohet ekzistenca e një prej shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, Gjykata, në bazë të neneve 18/4/c dhe 26 të ligjit “Për falimentimin”, të ndryshuar, vendos pranimin e kërkesës dhe hapjen në orën 14:00, të datës 15.12.2015 të procedurës së falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., duke emëruar si administratore të falimentimit znj. Mimoza Çibuku.

24. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

25. Për efekt të publikimit të këtij vendimi, në respektim të kërkesave të ligjit “Për falimentimin”, të ndryshuar, urdhërohet:

- Publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit Nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar).

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikën e Shqipërisë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

- Publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., në dy gazeta me qarkullim kombëtar, gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shqip”.



26. Bazuar në nenin 8/2 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar), për kryerjen e njoftimeve dhe shpalljeve publike, sipas nenit 9, të ligjit dhe caktimin e mbledhjeve brenda afateve të parashikuara në këtë vendim, ngarkohet administratorja e falimentimit, Mimoza Çibuku. Shpenzimet në lidhje në lidhje me këto veprime procedurale i ngarkohen masës së falimentimit. Si rrjedhim, një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet dhe administratores së falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., Mimoza Çibuku.

27. Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, që përbëhet nga taksa mbi aktet, shpenzimet për ekspert dhe shpenzimet kancelarike dhe njoftime, bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, ato janë në ngarkim të palës kërkuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuetit shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Hapjen në orën 14:00, të datës 15.12.2015, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., me administrator Astrit Kuçani, me seli në Tiranë, adresa: Rruga e Durrësit, Shkolla e Partisë.

3. Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “AL.P.IN” sh.a., të znj. Mimoza Çibuku, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 7, datë 15.10.2012, me adresë: rruga “Asim Vokshi”, nd. 86, h. 18, ap. 23.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Mimoza Çibuku.

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

8. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

9. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., Mimoza Çibuku.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikën e Shqipërisë.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

16. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

17. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., në dy gazeta me qarkullim kombëtar gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shqip”.

18. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuetit.



19. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes.

U shpall në Tiranë, sot në datën 15.12.2015

GJYQTARE
Marinela Osmani

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË
ASISTENCËS SOCIALE (SAMP)

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI
SHËRBIM KONSULENCE
PËR “EKSPERT LOKAL PROKURIM”
KONSULENT INDIVIDUAL LOKAL
REF. NO. SAMP/CS/IC/11-2015

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Hua nr. 8141- AL

Nr. i identifikimit të Projektit. P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (shërbim) së kërkuar është “**Ekspert lokal prokurim**”.

Konsulenti i prokurimit do të jetë përgjegjës për të siguruar se mallrat dhe shërbimet e konsulencës nën komponentin e dytë të Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) do të prokurohen në përputhje me udhëzimet e prokurimeve dhe konsulencës të Bankës Botërore (janar 2011). Eksperti i prokurimit i SAMP-së do të punojë me kohë të plotë. Detyra është planifikuar të fillojë në shkurt 2016 dhe të vazhdojë deri më 30 qershor 2017.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit SAMP pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë fton të gjithë konsulentët legjitimë (konsulentë) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimin e kërkuar.

Kriteret e shortlistimit janë:

1. Kualifikimet e përgjithshme 30 pikë;
2. Eksperienca të ngjashme 50 pikë;
3. Aftësia për të kryer shërbimin 20 pikë.

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore për: *Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA & Grant nga buamarrësit e Bankës Botërore* (udhëzuesi i konsulencës), version i janarit të 2011-s.

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhje sipas konsulencës individuale (IC), në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzuesit e Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve të Bankës Botërore* (versioni i janarit të vitit 2011).

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00-16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00-14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri më **22 janar 2016**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
– kati I

Rruga e Kavajës, nr. 53, Tirana, Albania
Në vëmendje të: znj. Suzana Papadhoppulli
e-mail: samp.papadhoppulli@gmail.com

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.